

Agjencia e
Mbikëqyrjes
Policore



AMP



RAPORT VJETOR 2024

08009090
www.amp.gov.al
ankesa@amp.gov.al

HYRJE

Agjencia, bazuar në misionin dhe objektin e veprimtarisë së saj, në radhë të parë duhet t'i shërbejë publikut, të jetë transparent, komunikues dhe të ketë një bashkëveprim të drejtpërdrejtë me qytetarët, për të evidentuar çdo rast të shkeljeve të kryera nga punonjës policie e jo vetëm, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Gjithashtu, Agjencia duhet të ushtrojë ndikimin e saj të vazhdueshëm në fushën e llogaridhënies dhe integritetit policor, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, si dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të kontrollit të jashtëm qytetar ndaj Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera mbikëqyrëse.

Veprimtaria e Agjencisë përgjatë vitit 2024 është fokusuar në zbatim të përgjegjësiwe ligjore dhe funksionale të përcaktuara në ligjin e saj organik, ligjin për vettingun si dhe në përmbushjen e prioriteteve, objektivave dhe masave konkrete në dokumentet strategjik sektorial dhe ndër sektorial, siç janë;

- ❖ *Strategjia për Zhvillimin e Agjencisë dhe Planit të Veprimit 2020 - 2024,*
- ❖ *Plani Kombëtar për Integrimin Evropian PKIE, 2023 - 2025”.*
- ❖ *Strategjisë Kombëtare Anti-Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2020 – 2024”,*
- ❖ *Programin Vjetor të Punës 2024”, i miratuar nga Ministri i Brendshëm, etj.*

REALIZIMI I PRIORITETEVE & OBJEKTIVAVE TË PLANIFIKUARA

- **Vijimi i procesit të Implementimit të Ligjit nr. 128/2021 për “Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”,** nëpërmjet hartimit dhe miratimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të tij, konkretisht:
 - **2 Vendime të Këshillit të Ministrave, të fokusuara në:**
 - *“trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Agjencisë”;*
 - *“përcaktimin e kriterëve të përfitimit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësit e Agjencisë”;*
 - **7 Plane masash & 15 Urdhra të brendshëm për ndjekjen e zbatimit me korrektësi të rregullave dhe normave të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjorë për procese të ndryshme pune.**
- **Rritja e efikasitetit të hetimeve proaktive** në funksion të goditjes së paligjshmërisë, në radhët e punonjësve të strukturave, kryesisht të Policisë së Shtetit, duke synuar nivelet e larta, të mesme dhe të parë drejtues të menaxhimit policor, jo vetëm ato në nivelet zbatuese/operacionale, e cila reflektohet në treguesit sasior e cilësor të veprimtarisë hetimore:
 - **23 % të numrit** të referimeve penale,
 - **35 % të numrit** të punonjësve të referuar,
 - **40 % të numrit** të hetimeve proaktive,
 - **33 % të numrit** të personave të arrestuar dhe masa sigurie me vendim gjykatë
- **Vijimi dhe konsolidimi i zhvillimit të procesit të Vlerësimit Kalimtar (Vettingu)**
– Trupat vlerësuese të Agjencisë kanë kryer procesin e hetimit administrativ për vlerësimin kalimtar për të tre komponentët *“figura, pasuria dhe profesionalizmi”* për subjektet e listave të shortuara gjatë vitit 2023, duke përmbyllur këtë proces për **62 subjekte**.
- **Dixhitalizimi/rritja e kapaciteteve të Agjencisë** - Me fondet buxhetore të akorduara është vazhduar edhe gjatë këtij viti, në sigurimin, implementimin dhe vënien në efikasitet të plotë të teknologjive bashkëkohore të informacionit, duke investuar në

pajisje bashkëkohore për **strukturat operationale dhe në procedurat e sigurisë dhe mirëmbajtjes së rrjeteve dhe sistemeve të Agjencisë.**

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore** – Plotësimi i vendeve vakante në strukturën organizative dhe funksionale të Agjencisë. Në zbatim të kriterëve të përcaktuara në ligjin organik dhe Rregulloren e Personelit të Agjencisë janë zhvilluar **8 konkurrime për 63 vende vakante, 109 numri i aplikantëve dhe 44 numri i kandidatëve fitues.**
- **Forcimi i kapaciteteve të brendshme të Agjencisë**, nëpërmjet trajnimit bazë për punonjësit e rinj si dhe trajnimit të vazhdueshëm dhe të avancuar për personelin ekzistues, në bashkëpunim me partnerët tanë brenda dhe jashtë vendit si; ICITAP Albania, EU4LEA, ekspertët e ROS¹, DHS², Akademia e Sigurisë, etj. Gjatë këtyre trajnimeve, seminareve dhe workshop-eve kanë marrë pjesë rreth **80 punonjës të Agjencisë**, ndër ta Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorë Drejtorie e Shefa Sektorësh, si dhe punonjës të rinj e të vjetër, pjesë e strukturave inspektuese e trajtimit të ankesave; strukturave të hetimit & analizës; si dhe strukturave të posaçme operationale, etj.
- **Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit rajonal** i konkretizuar në krijimin e “*Forumit Rajonal të Agjencive të Mbikëqyrjes Policore*” ndërmjet agjencive homologe të **4 vendeve të Ballkanit Perëndimor si; Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria**, themeluar në 3 Korrik 2023, në Prishtinë, Kosovë.
- **Forcimi i marrëdhënieve & rritja e transparencës në bashkëpunimin me qytetarët** - janë zhvilluar fushata promovuese për Agjencinë, në Sarandë, Ksamil, Delvinë, Gjirokastrë, Përmet, Shkodër, Lezhë, Tropojë, Kukës, Has, Elbasan dhe Tiranë, nëpërmjet takimeve me studentë dhe nxënës të shkollave të mesme si dhe në pikat e kalimit kufitar, ku qytetarët janë informuar mbi misionin e Agjencisë, objektin e veprimtarisë dhe mënyrat e kontaktit të agjencisë, në funksion të realizimit të misionit të saj, por edhe për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit me qytetarët.
- **Vijimi i angazhimit, përfaqësimit në grupe ndërinstitutionale dhe raportimit** nga ana e Agjencisë në kuadër të proceseve integruese në vend. Përmbushjes së detyrimeve sipas përgjegjësisve ligjore dhe funksionale të Agjencisë të parashikuara në dokumentet ndër sektoriale Strategjike si; Strategjia Ndër sektoriale dhe Planit të Veprimit Antikorrupsion, Plani Kombëtar i Integritetit Europian; Plani i Veprimit për zbatimin e Raportit të Raundit të V të GRECO-s; Strategjia Ndër sektoriale dhe Plani i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, etj.,

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Prioriteti kryesor i Agjencisë për vitin 2024, për të cilin është punuar fort, ka qenë angazhimi në aplikimin me cilësi e efikasitet të metodikave bashkëkohore të karakterit parandalues, siç janë Inspektimi, Vettingu, Trajtimi i Ankesave, CSP apo dhe veprimtaria inteligjente, po pa ulur cilësinë e veprimtarisë hetimore procedurale.

Treguesit statistikor për fushat kryesore të veprimtarisë së Agjencisë, pasqyrojnë nga njëra anë performancën e matur në vlera sasiorë dhe nga ana tjetër, performancën dhe pritshmërinë ndaj përmbushjes së përgjegjësisve ligjore, funksionale e organizative të matura në cilësi, efikasitet dhe efikasitet.

1. Mbikëqyrja nëpërmjet Hetimeve Proaktive dhe Hetimeve Procedurale Penale

Ka qenë dhe mbetet një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së Agjencisë, ku për vitin 2024 është synuar **rritja e efikasitetit të hetimeve proaktive** në funksion të goditjes së paligjshmërisë, në radhët e punonjësve të strukturave, kryesisht të Policisë së Shtetit, duke

¹ Grupit Special Operative të Karabinierisë Italiane, kryesisht të strukturave Mjeteve të Posaçme të Hetimit.


² Departamenti Amerikan i Akademisë së Udhëheqjes së Sigurisë Kombëtare.

synuar **nivelet e larta, të mesme e të parë drejtues të menaxhimit policor**, jo vetëm ato **në nivelet zbatuese/operacionale**. Gjithashtu fokusi është vënë në strukturat me **risk të lartë korrupsioni, si; kufiri, policia rrugore, hetimi i krimit, shërbimet ndaj të tretëve, etj.**

Treguesit e performancës së veprimtarisë hetimore procedurale, janë mjaft pozitive, falë vullnetit dhe përkushtimit të drejtuesve të Agjencisë, me një qasje drejt ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës nga njëra anë, por dhe mbështetjes dhe motivimit të punonjësve në përmbushjen e detyrave funksionale nga ana tjetër.

Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë me prokurorët, qofshin këta të Prokurorisë së Posaçme apo dhe të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm, për çështjet penale të referuara nga OPGJ-të e Agjencisë, në ndjekjen dhe kryerjen në kohë dhe me cilësi të detyrave të deleguara, ka qenë një vlerë e shtuar, në përpjekjet për të arritur dokumentimin ligjor dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme të kryer nga punonjës policie apo të strukturave mbikëqyrëse.

Në mënyrë të detajuar treguesit e veprimtarisë procedurale penale, si vijon:



Krahas referimeve nga strukturat e hetimit të Agjencisë, në cilësinë dhe përmbushjen e attributeve të Oficerit të Policisë Gjyqësorë, janë kryer me iniciativë ndalimet/arrestimet në kushtet e flagrancës si dhe ekzekutuar Vendimet e Gjykatave për **masat e sigurisë të karakterit ndalues dhe shtrëngues, 165 masa**, ndaj **138** punonjësve të strukturave e **27** shtetasve, konkretisht;

Arrestuar/ndaluar në flagrancë **48** persona, nga të cilët:

- **8** punonjës policie të rolit të parë drejtues
- **20** punonjës policie të rolit zbatues
- **3** efektivë të Gardës
- **1** efektiv i MZSH-së
- **16** shtetas

Masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” caktuar për **21** persona nga të cilët:

- **3** punonjës policie të rolit të parë drejtues
- **11** punonjës policie të rolit zbatues
- **7** shtetas

Masa e sigurimit personal “*arrest në shtëpi*” caktuar për 15 persona nga të cilët:

- 1 punonjës policie i rolit madhor
- 2 punonjës policie të rolit të parë drejtues
- 11 punonjës policie të rolit zbatues
- 1 shtetas

Masa e sigurimit personal “*pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik*” caktuar për 64 persona, nga të cilët:

- 2 punonjës policie të rolit të mesëm drejtues
- 16 punonjës policie të rolit të parë drejtues
- 45 punonjës policie të rolit zbatues
- 1 punonjës civil


Masa e sigurimit personal “*detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” caktuar për 17 persona nga të cilët:

- 5 punonjës policie të rolit të parë drejtues
- 9 punonjës policie të rolit zbatues
- 3 shtetas


Të dhënat mbi numrin e punonjësve të strukturave të arrestuar/ndaluar e me masa sigurie me vendim gjykate, evidentojnë orientimin e veprimtarisë hetimore gjithnjë e më shumë në nivelet e larta të menaxhimit policor, duke zbuluar, dokumentuar me prova ligjore & goditur veprimtarinë e kundërligjshme të kryer nga ana tyre, siç janë rasti i **1 drejtuesi të rolit madhor, 2 drejtues të rolit të mesëm dhe 34 drejtues të rolit të parë drejtues**, të gjithë në funksionet drejtor drejtorie e shefa sektorësh/seksionesh në strukturat qendrore & vendore të Policisë së Shtetit.

❖ **Tregues krahasimor për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024**


Të dhënat tregojnë se krahasuar me vitet e mëparshme, ato janë në nivelin më të lartë në më shumë se 10 vitet e fundit të veprimtarisë procedurale penale të Agjencisë.



Nr. punonjësish të referuar



Nr. personash të arrestuar/masa sigurie



2. Mbikëqyrja nëpërmjet Hetimit Administrativ të Ankesave & Inspektimit

Hetimi administrativ i Ankesave dhe kryerja e Inspektimeve zë një fushë të gjerë të kontrollit të strukturave policore që nga ajo e infrastrukturës ligjore, menaxhimit strukturor, funksional dhe organizativ të burimeve njerëzore dhe logjistike e deri tek lidhshipi, etika, sjellja individuale dhe kolektive e policisë.

Forcimi dhe rritja e cilësisë së trajtimit të ankesave dhe inspektimit nuk qëndron tek numri i ankesave të trajtuara e inspektimeve të kryera, por tek problematikat/tematikat për të cilën shqyrtohen ankesat dhe kryhen inspektimet, si dhe tek cilësia e gjetjeve/konkluzioneve dhe rekomandimeve që ju jepen strukturave objekt inspektimi.

1704 ankesa

- Ankesat e marra nga qytetarët drejtpërsëdrejti

3334 telefonata

- Linja e gjelbër 080 90 90

29 inspektime


- Inspektime të planifikuara

34 inspektime


- Inspektime të paplanifikuara

Për **283 punonjës policie** nga të cilët **1** punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues, **77** punonjës policie të nivelit të parë drejtues dhe **205** punonjës policie të nivelit zbatues është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për “*Shkelje të rënda*” pranë Komisionit të Hetimit Disiplinor të Agjencisë dhe për “*Shkeljet e lehta*” pranë Drejtorisë së Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit.

Nr. punonjësve sipas shërbimeve të policisë




Të ndarë sipas shërbimeve të policisë, punonjësit për të cilët është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor, i përkasin:



- Në të gjitha raste e tjera veprimet e punonjësve të policisë kanë qenë në përputhje me Procedurat Standarde të Punës.


Veprimtaria administrative, në aspekt krahasimor **viti 2023/2024**, rezulton se:

Ankesa




Ka rritje të ankesave që qytetarët kanë depozituar përmes portave të komunikimit që agjencia ka vënë në dispozicion, si; Zyra e Ankesave, linja jeshile 08009090, posta elektronike zyrtare, formulari on-line i ankesave, rrjete sociale, media e shkruar & elektronike, kutive postare, Whatsapp. etj. Janë marrë gjithsej **1704 ankesa**, krahasuar kjo me vitin 2023 kur janë administruar **1522 ankesa**, konstatohet se ka një rritje me **12 %**.

Inspektime



Janë kryer **63 inspektime** me një rritje prej **23 %**, krahasuar kjo me vitin 2023 kur janë kryer **51 inspektime**. Inspektimet e planifikuara në fillim të vitit u rritën 7 herë (**29 kundrejt 4 inspektimeve**) mbi bazën e analizës së riskut për strukturat me risk më të lartë korrupsioni apo veprimeve të tjera të kundërligjshme, njëkohësisht dhe për të kontrolluar dhe mbikëqyrur realizimin e rekomandimeve të lëna në inspektimet e kryera në vitet apo periudhat e mëparshme.

Rekomanduar për fillim hetimi disiplinor



Numri i punonjësve të policisë, për të cilët në përfundim të hetimit administrativ janë rekomanduar për fillimin e hetimit disiplinor për “*Shkelje të rënda*” pranë Komisionit të Hetimit Disiplinor dhe për “*Shkelje të lehta*”, në Drejtorinë e Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit është rritur në **283** punonjës policie kundrejt **177 punonjësve** për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me një rritje prej **60 %**.

3. Vijimi dhe konsolidimi i zhvillimit të procesit të Vlerësimit Kalimtar (Vettingu) – trupat vlerësuese të Agjencisë kanë kryer procesin e hetimit administrativ për vlerësimin kalimtar në të tre komponentët “*figura, pasuria dhe profesionalizmi*” për 72 subjektet e listave të dy shorteve të hedhura gjatë vitit 2023. Për vitin 2024 janë zhvilluar **62 seanca për 62 subjekte**, në përfundim të të cilave është vendosur;

- **46 vendime** për “*konfirmimin në detyrë*” të subjekteve të vlerësimit;
- **1 vendim** për “*përfundim nga detyra*” të subjektit të vlerësimit;
- **14 vendime** për “*ndërprerje e procesit të vlerësimit kalimtar*” – pasi “*pozicioni i punës është jashtë fushës së ushtrimit*”
- **1 vendim** për “*pezullim të procesit të vlerësimit*”.

4. Hetimi disiplinor i subjekteve mbikëqyrëse për shkelje të rënda

Produkti i siguruar nga hetimi administrativ i ankesave dhe kryerjes së inspektimeve shërben si indicie për fillimin e “**Hetimit Disiplinor për Shkelje të Rënda të punonjësve të strukturave mbikëqyrëse**” nga Komisioni i Hetimit Disiplinor të Agjencisë.

Komisioni i Hetimit Disiplinor të Agjencisë për vitin 2024, ka administruar në total **63 praktika për 130 punonjës policie**. Deri në fund të vitit janë shqyrtuar praktikat dhe marrë vendime për **88** punonjës policie, nga të cilët **34** punonjës policie niveli i parë drejtues dhe **54** punonjës policie niveli zbatues. Komisioni ka konkluduar, për dhënien e masave disiplinore, ku:

- Për 2 punonjës masa disiplinore “*Përfundim nga Policia e Shtetit*”;
- Për 3 punonjës masa disiplinore “*shtyrje afatit të gradimit 2 vite*”;
- Për 7 punonjës masa disiplinore “*shtyrje afatit të gradimit 1 vit*”;
- Për 7 punonjës masa disiplinore “*shtyrje afatit të gradimit 6 muaj*”;
- Për 23 punonjës dhënia e masës për “*shkelje të lehtë disiplinore*”;
- Për 22 punonjës “*përfundimi i hetimit disiplinor – pa shkelje disiplinore*”.

- Për 23 punonjës “mosfillimi i hetimit disiplinor – nuk konstatohej shkelja”.
- Për 1 punonjës “pezullimi i hetimit disiplinore – deri në përfundim të hetimit penal”.

Ndërsa për 42 punonjës, praktikantët e ardhura nga strukturat e vendore dhe qendrore të Agjencisë janë në proces shqyrtimi, nga Komisioni.

5. Mbikëqyrja nëpërmjet CSP/Pastërtisë së Figurës

Agjencia, si një nga tre Autoritetet Verifikuese në vend, ka organizuar & ndjekur punën për kryerjen e verifikimeve të kushtit të sigurisë në kuadër të:

- aplikimit të personave për Certifikatë të Sigurimit të Personelit,
- procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve sipas ligjit 84/2016
- procesit të vlerësimit të punonjësve të strukturave sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar
- procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016.

Në total janë trajtuar **11466 praktika** për **5831 aplikantë**, nga të cilët **2321** punonjës të strukturave të cilët kanë aplikuar për t'u pajisur me “CSP”.

AKSIK ka njoftuar për vendimmarrjen e saj, për **55 punonjës**, ku:

- ❖ “heqjen e CSP” për **8 punonjës**, nga të cilët:
 - 4 punonjës policie të rolit të parë drejtues
 - 2 punonjës policie të rolit zbatues
 - 2 punonjës të AMP
- ❖ “refuzim për pajisje me CSP” për **25 punonjës policie**, nga të cilët:
 - 1 punonjës policie i rolit të mesëm drejtues
 - 15 punonjës policie të rolit të parë drejtues
 - 8 punonjës policie të rolit zbatues
 - 1 punonjës administrative (civil)
- ❖ “pezullimin e përkohshëm të CSP” për **14 punonjës policie**, nga të cilët:
 - 1 punonjës policie i rolit të mesëm drejtues
 - 6 punonjës policie të rolit të parë drejtues
 - 7 punonjës policie të rolit zbatues

FENOMENET E PALIGJSHMËRISË/PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA

Nisur nga tërësia e të dhënave të siguruar nga denoncimet apo ankesat e shtetasve; të dhënat nga burimet e hapura apo të fshehta të informacionit, këto të fundit dhe në aplikim të metodave e teknikave speciale të veprimtarisë parandaluese; nga kryerja e inspektimeve të planifikuara dhe të paplanifikuara; procesit verifikues dhe shkëmbimit të ndërsjelltë të informacionit me autoritetet verifikuese në vend e jo vetëm; kallëzimeve të shtetasve apo hetimeve/procedimeve proaktive në ndjekje; evidentohen qartësisht disa prej fenomeneve më tipike/problematikat që bashkëjetojnë krahas gjithë punës pozitive që kryejnë strukturat e policisë në përmbushjen e detyrës dhe misionit ligjor të saj.

Konkretisht “shpërdorimi i detyrës”, e cila konsiston në mos kryerjen e detyrave që kanë funksionet e caktuara nga niveli i vijës së parë deri edhe tek funksionet drejtuese, vazhdon të jetë forma më klasike e paligjshmërive, e kryer qoftë si formë e vetme apo e gërshtuar me shkelje të tjera ligjore. Shpërdorimi i detyrës konsumohet në rastet e mos aplikimit të autorizimeve dhe kompetencave ligjore sipas çdo funksioni dhe strukture. Ndërsa nga funksionet drejtuese konsumohet nga përgjegjës strukturash që kanë kompetenca drejtimi dhe menaxhimi.

Ndërsa në rastin e “korrupsionit aktiv ose pasiv”, funksionet e policisë shpërdorojnë detyrën duke marrë përsipër të kryejnë ose të mos kryejnë një veprim të caktuar, mbas të

cilit përfiton mendimi kriminal nga njëra anë dhe nga ana tjetër përfiton materialisht ose financiarisht edhe autori, subjekti policor.

Konkretisht të shprehura në %, rezulton se:

<i>Shpërdorim detyre & korrupsion pasiv</i>	→	37% e totalit të referimeve penale
<i>Shpërdorim detyre & favorizim të paligjshmërisë</i>	→	20% e totalit të referimeve penale
<i>Kryerje e veprimeve arbitrare</i>	→	16% e totalit të referimeve penale
<i>Dëmtime me dashje, dhunë në familje, etj,</i>	→	14% e totalit të referimeve penale
<i>Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor</i>	→	13% e totalit të referimeve penale

Por siç rezulton dhe nga të dhënat, një përqindje të konsiderueshme, rreth **43 % e totalit** të referimeve e zënë shkeljet/veprimet që kryejnë punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat prekin dhe cenojnë lirinë e shtetasve si dhe dhënia e urdhrave arbitrare kryesisht nga niveli i parë drejtues (shef seksioni/ sektori/ stacioni policie/ shef komisariati).

MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Për vitin 2024, Agjencia ka përfituar fonde buxhetore në realizimin e projekteve të planifikuara, e konkretisht:

- “përforcim dhe shtesë kati në godinën e AMP” – në vlerën 34,800 mijë lekë;
- “prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” – në vlerën 5850 mijë lekë;
- “programi i menaxhimit të burimeve njerëzore & Financa 5” – në vlerën 2,167 mijë lekë;
- “mobiliteti i shtesës së katit të godinës së AMP-se” – në vlerën 6,500 mijë leke.

Gjithashtu dhurimi dhe dorëzimi si ndihmë teknike e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve të Agjencisë në vlerën e 1.2 milion dollarësh nga Programi Ndërkombëtar i Departamentit të Drejtësisë i Ndihmës për Trajnimin për Hetimet Penale (ICITAP).

Fonde buxhetore të akorduara në shumën prej **324,196,000** lekë (duke përfshirë ndryshimet gjatë vitit), fond i cili është realizuar në shumën prej **316,802,206** lekë ose në masën **97%**, detajuar në pasqyrën përmbledhëse të realizimit të shpenzimeve buxhetore të artikujve kryesor të strukturës buxhetore;

Nr.	Art.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Real. në %
1.	600	Paga & shpenz. personeli	212,794,000	209,339,356	3,454,644	98%
2.	601	Sig.shoqërore&shëndetësore	34,337,000	33,557,343	779,657	98%
3.	602	Mallra e shërbime	48,000,000	44,546,332	3,453,668	93%
4.	606	Transf. buxhetet familjare	10,114,000	10,110,400	3,600	100%
5.	230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të patrupëzuara	2,601,000	2,434,800	166,200	94%
6.	231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara	16,350,000	15,518,851	831,149	95%
TOTALI			324,196,000	315,507,082	8,688,918	97%

- shpërblimi i punonjësve për rezultate në luftën kundër korrupsionit & arritje të veçanta.
- zbatimi dhe ndjekja e rekomandimeve të lëna nga Misioni i Auditit të kryer për periudhën Maj 2022 – Qershor 2024.

❖ **Për menaxhimin e burimeve njerëzore**

Në zbatim të kriterëve të përcaktuara në ligjin organik dhe Rregulloren e Personelit të Agjencisë janë zhvilluar:

- 8 konkurrenca për 63 vende vakante,
- 109 numri i aplikantëve dhe
- 44 numri i kandidatëve fitues.
- Janë emëruar në detyrë 44 punonjës,
- Janë larguar nga detyra 28 punonjës me motivacione të ndryshme, ku:
 - 25 punonjës me motivacionin “Me kërkesën e tij”;
 - 1 punonjës me motivacionin “masa disiplinore “Përfundim nga Agjencia”;
 - 1 punonjës me motivacionin “pranuar në kundërshtim me ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - 1 punonjës ka dalë në pension pleqërie.

❖ **Masat Disiplinore**

Janë hetuar dhe verifikuar gjithsej 5 punonjës të Agjencisë, ku për:

- 3 punonjës është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
- 1 punonjës është vendosur “Tërheqje vëmendje”;
- 1 punonjës është dhënë masa disiplinore “Përfundim nga AMP”.

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL/PROCESET INTEGRUESE TË SHQIPËRISË NË BE

Vijimi i angazhimit, përfundimit në grupe ndërinstitucionale dhe raportimit nga ana e Agjencisë në kuadër të proceseve integruese në vend. Gjatë vitit është raportuar në kuadër të përmbushjes së detyrimeve sipas përgjegjësisë ligjore të Agjencisë të parashikuara në dokumentet Ndërsëktoriale Strategjike si;

- Strategjia Ndër sektoriale dhe Plani i Veprimit Antikorrupsion,
- Plani Kombëtar i Integritetit Evropian;
- Plani i Veprimit për zbatimin e Raportit të Raundit të V të GRECO-s;
- Strategjia Ndër sektoriale dhe Plani i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, etj.,
- Takimi i 15-të Shqipëri – Bashkimi Evropian i Nënkomitetit “Drejtësia, Liria, Siguria”.
- Udhërrëfyesi Anti-Korrupsion në kuadër të UNDOC.
- Pyetëtori i DASH për vitin 2024 në kuadër të Trafikimit të Personave, etj.

Agjencia është një nga 55 institucionet kontribuese për Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kriteri Politik “Funksionimi i Institucioneve Demokratike”, që janë dy nga kapitujt kyç në procesin e hapjes dhe ndjekës së procesit të negociatave teknike të vendit tonë me Bashkimin Evropian.

1. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional rajonal dhe ndërkombëtar
Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit rajonal i konkretizuar në krijimin e “**Forumit Rajonal të Agjencive të Mbikëqyrjes Policore**” ndërmjet agjencive homologe të 4 vendeve të Ballkanit Perëndimor si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria, themeluar në 3 Korrik 2023, në Prishtinë Kosovë. Përgjatë këtij viti në kuadër të këtij Forumi, janë zhvilluar disa takime, si:

- 25 – 26 Mars 2024, në Prizren të Kosovës, ku u nënshkrua “Statuti i këtij Forumi” dhe plani i punës për aktivitetet në vijim.
- 7 – 8 Tetor 2024, në Budva, Mali i Zi, ku vendet pjesëmarrëse shkëmbyen praktikat më të mira në fushën e integritetit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm policore, nëpërmjet mekanizmave parandalues dhe represive të saj.

- Vizita studimore/ shkëmbimin e përvojave me pjesëmarrës nga agjencitë/ departamentet e Mbikëqyrjes Policore të Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës, në datat 2 – 4 Dhjetor 2024, në Vushtri, Kosovë, organizuar nga Inspektoriati Policor i Kosovës me mbështetjen e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP).

2. Forcimi i marrëdhënieve e rritja e transparencës në bashkëpunimin me qytetarët

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka intensifikuar punën gjatë vitit 2024 për rritjen e bashkëpunimit me qytetarët në funksion të realizimit të misionit të saj, duke vijuar fushatën promovuese në qytete të ndryshme të vendit, nëpërmjet takimeve me qytetarë, studentë dhe nxënës të shkollave të mesme.

Përfaqësuesit e Agjencisë janë shoqëruar nga Këshilltari i Lartë për Llogaridhënien Policore nga Programi ICITAP në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë Z. Rick Bates, i cili gjatë takimeve ka theksuar mbështetjen e ambasadës amerikane për Agjencinë në funksion të zbatimit të ligjit dhe garantimit të të drejtave të qytetarëve për të pasur një shërbim policor korrekt dhe të standardeve më të larta evropiane. Ai ka theksuar sërish nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë Agjenci – publik, si një prej mënyrave më të rëndësishme për ushtrimin e mbikëqyrjes civile në funksion të pastrimit të Policisë së Shtetit nga çdo paligjshmëri.

Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e Agjencisë kanë prezantuar misionin, objektin e veprimtarisë, organizimin dhe mjetet e komunikimit, përmes të cilave qytetarët mund të dërgojnë ankesat e tyre për punonjës të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, apo shërbimit Zjarrfikës, konkretisht:

- Në Korçë dhe Pogradec - Janë organizuar takime me qytetarë, studentë & nxënës të maturës, në;
 - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
 - Shkolla e mesme "Themistokli Gërmenji", Korçë
 - Shkolla e mesme "Raqi Qirinxhi", Korçë
 - Shkolla e mesme "Muharrem Çollaku", Pogradec
 - Pika e Kalimit Kufitar "Kapshticë"
 - Pika e Kalimit Kufitar "Qafë Thanë"
- Në Gjirokastrë, Përmet dhe Tepelenë - Janë organizuar takime me qytetarë, studentë & nxënës të maturës, në;
 - Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë
 - Shkolla e mesme "Siri Shaplo" në Gjirokastrë
 - Shkolla e mesme "Sami Frashëri" në Përmet
 - Shkolla e mesme "Abaz Shehu" në Tepelenë
 - Pika e Kalimit Kufitar "Kakavijë"
 - Pika e Kalimit Kufitar "Tre Urat"
- Në Vlorë - Janë organizuar takime me studentë në;
 - Universitetin "Ismail Qemali"
- Në Sarandë, Delvinë dhe Ksamil - Janë organizuar takime me qytetarë dhe nxënës të maturës, në;
 - Shkolla e mesme "Hasan Tahsimi" në Sarandë
 - Shkolla e mesme "Sulejman Delvina" në Delvinë
 - Shkolla e mesme e bashkuar "5 Dëshmorët", Ksamil
 - Pika e Kalimit Kufitar "Porti Sarandë"
 - Pika e Kalimit Kufitar "Qafë Botë"

- Në Shkodër dhe Lezhë - Janë organizuar takime me nxënës të maturës, në;
 - Shkolla e mesme “Oso Kuka” në Shkodër,
 - Shkolla e mesme “28 Nëntori” në Shkodër
 - Shkolla e mesme “Hydajet Lezha” në Lezhë
- Në Berat, Kuçovë dhe Lushnje - Janë organizuar takime me nxënës të maturës, në;
 - Shkolla e mesme “5 Tetori” në Kuçovë,
 - Shkolla e mesme “Kristaq Capo” në Berat
 - Shkolla e mesme “18 Tetori” në Lushnje
- Në Kukës, Tropojë dhe Krumë - Janë organizuar takime me qytetarë, studentë dhe nxënës të maturës, në;
 - Shkolla e mesme "Havzi Nela ", Kukes,
 - Shkolla e mesme "Asim Vokshi", Bajram Curri
 - Shkolla e mesme "Skënderbeu", Krumë
 - Pika e Kalimit Kufitar “Morinë”
- Në Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel - Janë organizuar takime me qytetarë, studentë dhe nxënës të maturës, në;
 - Shkolla e mesme “Sahit Najdini” në Peshkopi,
 - Shkolla e mesme “Arbëria” në Bulqizë
 - Shkolla e mesme “Pjetër Budi” në Burrel
 - Pika e Kalimit Kufitar “Bllatë”
- Në Tiranë - Janë organizuar takime me studentë në;
 - Fakultetin Juridik në Universitetin e Tiranës
 - Fakultetin Ekonomik në Universitetin Bujqësor të Tiranës
- Në Elbasan - Janë organizuar takime me studentë në;
 - Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan
- Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë edhe materiale informuese, e konkretisht;
 - 3000 Fletëpalosje
 - 2000 Kartvizita
 - 400 kopje të Revistës “Mbikëqyrja Policore”

PRIORITETET/OBJEKTIVAT VJETORE TË AGJENCISË

Agjencia ka parashikuar të përmbushë, këto prioritete dhe objektiva, në përputhje e zbatim të prioriteteve të qeverisë shqiptare & Ministrisë të Brendshme në fushën e sigurisë, zbatimit të ligjit & të mbikëqyrjes së jashtme policore; të rekomandimeve në Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë; si dhe të rekomandimeve e sugjerimeve të partnereve tanë më të ngushtë ICITAP Albania e EU4LEA, e konkretisht:

- ❖ Agjencia do të vazhdojë të angazhohet në aplikimin me cilësi e efikasitet të metodikave bashkëkohore të karakterit parandalues, si; Inspektimi i performancës, Vettingu (vijimi i Vlerësimit Kalimtar & fillimin e Vlerësimit Periodik), Trajtimi i ankesave, CSP, Hetimi administrativ apo & Veprimtaria inteligjente, pa ulur cilësinë e veprimtarisë Hetimore Procedurale.
- ❖ Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit kryesisht me Prokurorinë e Posaçme (SPAK), Prokuroritë e Shkallës së Parë, Policinë e Shtetit, SHISH, AISM, AKSIK, etj do të jetë prioritet i punës sonë.
- ❖ Forcimi i kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes në sasi e cilësi të infrastrukturës logjistike, teknike, sisteme e programe të teknologjisë

bashkëkohore, nga njëra anë dhe trajnimit të vazhduar dhe të avancuar të personelit nga ana tjetër.

- ❖ Vijimit të konsolidimit të bashkëpunimit rajonal si pjesë e “Forumit Rajonal të Organizmave të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes Policore” të vendeve të Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.
- ❖ Përbushja e detyrimeve të Agjencisë që rrjedhin nga Strategjitë Ndër sektoriale dhe Planet Konkrete të Veprimit e angazhimit të vazhdueshëm në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për ndjekjen dhe përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimet e lëna nga BE për institucionet shqiptare, në kuadër të aderimit të Shqipërisë në BE-në.
- ❖ Rritja e besimit dhe bashkëpunimit me qytetarët do të vazhdojë të jetë busulla jonë orientuese për një shoqëri më të sigurt dhe të qetë falë punës dhe përkushtimit të punonjësve të ndershëm dhe profesionistë ligjit.